



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:278806

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05559275

C. nr. 1146/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Artan Abazi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D. M. nga, lagjja “Malësia”, të cilin me autorizim nga ANJF, e përfaqëson Lulzim Canaj, avokat nga Kamenica, kundër të paditurës A. H. ngame objekt kontesti për ndryshimin e Aktvendimit të plotëfuqishëm të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, të datës 24.03.2021, më shenjën C.nr.26/2021, jashtë seancës, më datë 02.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET se është tërhequr padia me numër C. nr. 1146, e datës 12.12.2023, e paditësit D. M ngaashtruar kundër të paditurës A. H. nga fshati Gjilani, rruga “Sadulla Brestovci”, me objekt kontesti për ndryshimin e Aktvendimit të plotëfuqishëm të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, të datës 24.03.2021, më shenjën C.nr.26/2021.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi D. M. nga,” përmes të autorizuarit nga ANJF, Lulzim Canaj, avokat nga Kamenica, në këtë gjykatë ka parashtruar padi më datën 12.12.2023, kundër të paditurës A. H. nga, me objekt kontesti për ndryshimin e Aktvendimit të plotëfuqishëm të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, të datës 24.03.2021, më shenjën C.nr.26/2021

Gjykata, të autorizuarit të palës paditëse, avokatit Lulzim Canaj nga Kamenica, Aktvendimin C.nr.1146/2023, të datës 15.03.2024, për plotësimin e padisë me adresën e plotë të të paditurës A. H. nga, i’a ka dërguar më datën 15.03.2024. Po ashtu, gjykata përmes këtij aktvendimi e ka paralajmruar të autorizuarin e palës paditëse se po që se nuk vepron konform aktvendimit të lartëcekur, gjykata do të konsideroj të tërhequr padinë e paditësit.

Ndërsa, edhe pse i autorizuari i palës paditëse, Aktvendimin C.nr.1146/2023, të datës 15.03.2024, e ka pranuar më datën 18.03.2024, dhe nga kjo datë ka qenë i njoftuar për

detyrimin e caktuar nga Gjykata dhe afatin ligjor për përmbushjen e detyrimit, për plotësimin e padisë me adresën e plotë të të paditurës, i njëjti nuk ka vepruar konform aktvendimit, respektivisht nuk e ka plotësuar padinë e datës 12.12.2023, me adresën e plotë për të paditurën, respektivisht i njëjti nuk është përgjigjur fare ndaj aktvendimit të lartëcekur të gjykatës.

Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha të lartëcekurat, si dhe faktin se pala paditëse, respektivisht i autorizuari i saj, nuk e ka përmbushur detyrimin e lartëcekur të caktuar nga Gjykata, pra në Gjykatë nuk ka dorëzuar asnjë parashtrësë për të njoftuar Gjykatën se e ka bërë plotësimin e padisë të datës 12.12.2023, me adresën e plotë për të paditurën dhe duke pasur parasysh që ka kaluar afati ligjor prej 3 diteve, brenda të cilit afat pala paditëse e ka pasur për obligim, që ta përmbush detyrimin e lartëcekur, e duke u bazuar në dispoziten e nenit 99, 102, e lidhur me dispoziten e nenit 387 paragrafi 1, pika q), të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C. nr. 1146/2023, më datë 02.04.2024

G j y q t a r i
Artan Abazi, d. v

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimi të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.